

RAPORT VLERËSIMI (I)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Fakulteti i Filozofisë

19 qershor 2012

PËRMBLEDHJE	4
Hyrje.....	4
Procesi i shqyrtimit	4
I) GJETJET E PËRGJITHSHME PËR FAKULTETIN E FILOZOFISË	7
1. Deklarata e Misionit.....	8
2. Organizimi dhe Menaxhmenti	9
3. Personeli i Fakultetit	11
4. Financat	13
5. Plani zhvillimor	14
6. Menaxhimi i Cilësisë.....	15
7. Puna Kërkimore dhe Ndërkombëtarizimi	16
II) PROGRAMET E STUDIMIT NË PËRGJITHËSI.....	18
III) PROGRAMET E STUDIMIT NË DETAJE.....	19
1. Filozofi (BA).....	19
1.1 Gjetjet e Përgjithshme	19
1.2 Gjetjet në lidhje me çështjet e punës kërkimore.....	19
Rekomandimet në lidhje me çështjet e punës kërkimore.....	20
1.3 Gjetjet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar.....	20
Rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gjuhët e huaja	20
1.4 Gjetjet në lidhje me librat dhe publikimet mësimore.....	21
Rekomandimet në lidhje me librat dhe publikimet mësimore.....	21
1.5 Gjetjet në lidhje me personelin mësimor	21
Rekomandimet në lidhje me personelin mësimdhënës	22
1.6 Gjetjet në lidhje me programet studimore dhe caktimin e ECTS.....	22
Rekomandimet në lidhje me programet studimore dhe me caktimin e ECTS.....	22
Rekomandim Përfundimtar	22
2. Histori (BA/MA/PHD).....	23
2.1 Vërejtje të përgjithshme	23
2. 2 Programi BA në Histori.....	24
2.2.1 Gjetjet e Përgjithshme	24
2.2.2 Gjetjet në lidhje me çështjet kërkimore	25
Rekomandimet në lidhje me çështjet kërkimore.....	25
2.2.3 Gjetjet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar.....	25
Rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gjuhët e huaja	26
2.2.4 Gjetjet në lidhje me librat dhe materialin mësimor.....	26
Rekomandimet në lidhje me tekstet dhe publikimet mësimore	26
2.2.5 Gjetjet në lidhje me Personelin Mësimor.....	26
Rekomandimet në lidhje me personelin mësimdhënës	27

2.2.6 Gjetjet në lidhje me programet e studimit dhe caktimin e ECTS.....	27
Rekomandimi në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS	27
Rekomandimi Përfundimtar	27
2.3 Programi MA në Histori.....	28
2.3.1 Vërejtjet e Përgjithshme dhe Gjetjet.....	28
2.3.2 Gjetjet në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS	28
Rekomandimi Përfundimtar	28
2.4 Programi PhD në Histori.....	29
2.4.1 Vërejtjet e përgjithshme dhe Gjetjet.....	29
2.4.2 Gjetjet në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS	30
Rekomandimi Përfundimtar	30
3. Pedagogji (BA/MA/PhD).....	31
3.1 Gjetje të Përgjithshme	31
3.2 Gjetjet në lidhje me çështjet e punës kërkimore.....	31
Rekomandimet në lidhje me çështjet e kërkimit.....	32
3.3 Gjetjet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar.....	33
Rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gjuhët e huaja	33
3.4 Gjetjet në lidhje me librat dhe publikimet mësimore.....	33
Rekomandimet në lidhje me librat dhe materialet mësimore	34
3.5 Gjetjet në lidhje me personelin mësimor	34
Rekomandimet në lidhje me personelin mësimdhënës	34
3.6 Gjetjet në lidhje me Programet Studimore dhe caktimin e kredive ECTS	34
Rekomandimet në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS.....	35
Rekomandimi përfundimtar	36

Përmbledhje

Hyrje

Ekipi i Ekspertëve (EE) është mirënjohës ndaj fakultetit për mikpritjen e ekipit të jashtëm vlerësues gjatë vizitës së tyre në institucion të zhvilluar më 19 qershor 2012. EE do të donte të shprehte mirënjohjen e vet ndaj Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK) dhe përfaqësuesve të saj, Prof. Dr. Ferdije Zhushi – Etemi dhe Magjistër Basri Muja për mbështetjen e tyre, për bashkëpunimin dhe mikpritjen e treguar gjatë vizitës sonë në institucion.

Duke marrë parasysh gjendjen e vështirë dhe sfiduese të tranzicionit të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe të Fakultetit të Filozofisë (FF) me të cilën gjendje ato janë përballuar gjatë dy dekadave të fundit, EE do të donte të shprehte vlerësimin e vet sa i përket përpjekjeve për zhvillimin e mëtejshëm. Për këtë arsye raporti synon që të ofrojë kontributin e vet në thellimin e mëtejshëm të ngritjes së misionit të fakultetit dhe të programeve të tij të studimit.

Në të shumtën e rasteve rekomandimet janë të orientuara ndaj dekanit dhe personave përgjegjës për programet e studimit, por sfidat dhe vizioni për të ardhmen janë diçka që duhet të diskutohet së bashku me institucionin dhe të pranohen nga të gjithë pjesëtarët e këtij komuniteti.

Procesi i shqyrtimit

Procesi i shqyrtimit dhe ky raport përfundimtar janë f kusuar në kërkesat e AAK dhe synimet kryesore të standardeve ndërkombëtare të arsimit të lartë. Nga AAK janë vënë në dispozicion para vizitës në institucion materialet instruktive siç janë Standardet për Akreditim nga AAK, Kodi i Praktikave të Mira për Vizitë në Institucion si dhe Raporti i Vlerësimit të Ekspertëve i vitit 2009 (RVE). Në lidhje me rekomandimet ndaj FF, EE në vlerësimin e bërë kanë marrë në konsideratë masat e marra ose që nuk janë marrë në mënyrë që ato të jetësohen.

Ky raport është i bazuar në

- Raportin e Vetë-Vlerësimit (RVV) të Fakultetit të nëntorit 2011;
- Gjetjet e grumbulluara gjatë vizitës në institucion më 19 qershor 2012;
- Dokumentet e dorëzuara nga FF pas vizitës në institucion (VNI) sipas kërkesës nga EE gjatë VNI (plani i buxhetit të FF, plani i zhvillimit të FF, skema e përbërjes së senatit të UP, përbërja e bordit të Universitetit, u kërkuar edhe një kopje e revistës së fakultetit, megjithatë ajo nuk pati mundësi të dorëzohej në kohë).

EE për vlerësim të jashtëm të FF përbëhej nga pjesëtarët në vijim:

- Dr. Tuula Asunta/ Universiteti i Jyväskylä, Finlandë
- Dr. Pavo Barisic/ Universiteti i Splitit, Kroaci
- Dr. Konrad Clewing/ Instituti për Hulumtime të Evropës Lindore dhe Jugore, Regensburg, Gjermani
- Dr. Angelika Seppi/ Universiteti i Vjenës, Austri

VNI e datës 19 qershor 2012 u zhvillua me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të EE të shoqëruar nga përfaqësuesit e AAK Dr. Zhushi-Etemi dhe Mr. Muja, kjo vizitë ka filluar me një takim me menaxhmentin e fakultetit të përfaqësuar nga:

- Ø Prof. Asoc. Dr. Ramush Mavriqi, Dekan i Fakultetit
- Ø Prof. Asoc. Dr. Demë Hoti, Pro-Dekan për Arsim;
- Ø Ass. MSc. Ardian Gola, Koordinator për Zhvillim Akademik në Fakultet.

Takimi me Menaxhmentin e FF përbëhej nga diskutimi në lidhje me çështjet e cekura më poshtë:

- Ø Deklarata e Misionit
- Ø Organizimi dhe Menaxhimi
- Ø Personeli i Fakultetit
- Ø Financat
- Ø Plani i Zhvillimit
- Ø Menaxhimi i Cilësisë
- Ø Puna kërkimore dhe ndërkombëtarizimi
- Ø Rekomandimet nga vlerësimi pararendës

Pas takimit të parë, EE pati mundësinë të vizitojë disa nga hapësirat e FF, me një fjalë bibliotekën e FF dhe klasat kryesore të ligjërimit si dhe disa nga auditoriumet e FF që janë rinovuar së voni.

Pas një dreke pune me biseda në mes të EE dhe përfaqësuesve të AAK, VNI pasoi me një takim me përfaqësuesit e programeve të studimit që janë relevante për vlerësimin e bërë. Si rrjedhojë e këtyre takimeve, EE u nda varësisht nga fushat e tyre të ekspertizës:

- Ø Departamenti i Filozofisë Dr. Pavo Barisic / Dr. Angelika Seppi
- Ø Departamenti i Historisë Dr. Konrad Clewing
- Ø Departamenti i Pedagogjisë Dr. Tuula Asunta

Diskutimet me përfaqësuesit e departamenteve të veçanta u fokusuan në çështjet në vijim:

- Ø Kurrikula
- Ø Mësimdhënia
- Ø Puna Kërkimore
- Ø Rekomandimet nga vlerësimi pararendës

Diskutimet me përfaqësuesit e departamenteve, u pasuan nga një takim me studentët si dhe një takim me personelin mësimdhënës.

Pas një konsultimi të shkurtër në mes të anëtarëve të EE dhe përfaqësuesve të AAK, u zhvillua takimi përmbyllës me menaxhmentin e fakultetit. Në këtë pikë, u komunikua itinerari i procesit të vlerësimit dhe u kërkuan dokumentet shtesë të cekura më sipër.

I) Gjetjet e Përgjithshme për Fakultetin e Filozofisë

Gjetjet e përgjithshme ndjekin listën e çështjeve që janë diskutuar me menaxhmentin e fakultetit. Pyetjet në lidhje me zbatimin e rekomandimeve janë shprehur nga EE në Raportin e EE të 2009, ato janë përfshirë në kapitujt korrespondues. Vetë diskutimet me menaxhmentin e FF janë proceduar në përputhje me pyetjet kryesore të Udhëzuesit për Ekspertë të AAK.

Siç është cekur në Hyrjen e këtij raporti, EE vlerëson përpjekjet e ndërmarra nga FF për të ngritur më tej kapacitetet akademike dhe administrative, si dhe synimet ambicioze që do të japin kontributin e vet ndaj adresimit të sfidave sociale të shoqërisë kosovare me të cilat ajo ndeshet, kjo përmes të ofruarit studentëve një arsim të cilësisë së lartë.

Në vijim të VNI, përfaqësuesit e FF kanë cekur disa herë vështirësitë që rrjedhin nga konteksti socio-historik, si dhe barrierat ndaj ndryshimeve të imponuara nga struktura e universitetit e centralizuar në mënyrë strikte. Duke qenë se UP dhe FF janë ende në procesin e tranzicionit, nuk mund të pritët që pengesat e cekura do të zgjidhen lehtësisht në të ardhmen afatshkurtër. Megjithatë, duhet të mbetet si preokupim i FF, veçanërisht duke marrë parasysh drejtimin humanistik të vet dhe vizionin për të kontribuar në “proceset e përgjithshme sociale në Kosovë”¹ – të ndërlidhë nismat në një nivel të planifikimit strategjik.

¹RVV, f. 5.

1. Deklarata e Misionit

Gjetjet dhe rekomandimet

Dëshmitë e dhëna përmes RVV dhe diskutimet me përfaqësuesit në takimin e parë, dëshmuar që kritikën e dhëna përmes Raportit të EE të 2009 (pëngesat në lidhje me pozitat, rolet dhe orientimin strategjik të FF brenda kontekstit të përgjithshëm të UP, fokusi i fuqishëm në mësimdhënie që binte ndesh me përmirësimin e punës kërkimore, mungesa e specifikave sa i përket përshkrimit të strategjive për të arritur synimet e arsimit dhe në fund edhe mungesa e mjeteve) që të gjitha dukej se ishin marrë në konsiderim në mënyrë serioze.

Deklarata e misionit e cekur në RVV të 2011 është konkretizuar sa i përket vizionit të FF dhe synimeve të mëtejme të edukimit dhe hulumtimit, përmes të cilave pritet që vizioni të zbatohet. Veçanërisht sa i përket rekomandimit të Raportit të EE për përmirësimin e komunikimit ndërmjet fakulteteve, si dhe fuqizimin e orientimit hulumtues të fakultetit, të gjitha këto kishin gjetur përgjigje përmes ngritjes së një Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike përmes të cilit do të publikohet një revistë periodike. Megjithatë faktin se projekti është ende në fillimet e veta, prapëseprapë përpjekjet e bëra meritojnë të mirëprehen.

Përveç këtij hapi të ndërmarrë, megjithatë strategjia e zbatimit ende shfaq mangësi sa i përket qartësisë dhe përmbajtjes. Për këtë arsye plani i zhvillimit strategjik përbëhet nga një listim i synimeve shtesë në vend se të paraqesë një strategji hap pas hapi dhe të ndërlidhur me aspektin kohor. EE rekomandon elaborimin e planit të zhvillimit strategjik brenda fakultetit (në nivelin e këshillit dhe/ose të nivelit të dekanëve). Edhe nëse ai dokument mund të mos pranohet plotësisht nga rektorati, ai do të ndihmonte në artikullimin e nevojave dhe dëshirave të fakultetit, në momentin kur dekani i FF të marrë pjesë në zhvillimin e strategjisë akademike në senat. Kjo do të mund të ndikonte që në mënyrë indirekte të ndiqen interesat e FF kur të zhvillohet strategjia akademike nga Senati dhe Rektorati. Elaborimi i një strategjie të tillë brenda FF do të mund të zhvillonte më tej shpirtin ekipor mes gjithë personelit në nivel të FF, që duket se në këtë fazë mungon në një masë të madhe.

EE vlerëson nismat e ndërmarra nga menaxhmenti i FF për të përmbushur rekomandimet e 2009. Por, ende rekomandohet që të vihet fokus edhe më i fuqishëm në planifikimin strategjik dhe të merret në konsiderim mbështetja e zhvillimit të tij përmes ekspertëve të jashtëm. Poashtu rekomandohet që të bëhet një fuqizim i mëtejme i rrjetëzimit të përgjithshëm në mes departamenteve të veçanta si dhe ndërlidhjes së tyre me hulumtimet dhe mësimdhënien, pjesërisht edhe në nivel interdisiplinar.

2. Organizimi dhe Menaxhmenti

Gjetjet dhe Rekomandimet

Siç është cekur në RVV, FF tani përbëhet nga 8 departamente që ofrojnë studime deri në nivelin e cekur:

- Ø Departamenti i Filozofisë (BA, MA, në proces të riakreditimit)
- Ø Departamenti i Historisë (BA, MA, PHD, në proces të riakreditimit)
- Ø Departamenti i Pedagogjisë (BA, MA, PHD, në proces të riakreditimit)
- Ø Departamenti i Sociologjisë (BA, MA, PHD, gjatë VNI të datës 19 qershor nuk u trajtua çështja e riakreditimit)
- Ø Departamenti i Shkencave Politike (BA, MA)
- Ø Departamenti i Psikologjisë (BA)
- Ø Departamenti i Etnologjisë (BA)
- Ø Departamenti i Punës Sociale (BA)

Siç është cekur në RVV, ofrimi i programeve të studimeve ka ndryshuar në kohë të ndryshme gjatë dekadës së fundit. Në zbatimin e programeve të studimeve janë të përfshirë 96 ligjërues (62 nga ta të rregullt, 7 të përfshirë nga departamentet tjera të UP dhe 27 ligjërues të asocuar).

Duke marrë parasysh dëshmitë në RVV dhe diskutimet me menaxhmentin e FF, EE ndan pikëpamjen e shprehur në Raportin e EE të 2009 që FF është i strukturuar në departamente pak a shumë të pavarura, që bregosën para së gjithash me organizimin e vet, qoftë në nivel akademik apo atë administrativ. Bazuar në RVV dhe në informatat e marra gjatë diskutimeve, Instituti për Studime Sociale Humanistike i cekur më sipër, është themeluar në vitin 2011 me synimin që të trajtojë mungesën e bashkëpunimit në hulumtime interdisiplinare në Fakultet.

Mungesa e bashkëpunimit interdisiplinar në mes departamenteve tashmë është adresuar në Raportin e EE të vitit 209 sa i përket mungesës së identitetit të fakultetit në përgjithësi. EE i këtij raporti vëren se përmes kësaj qasjeje organizative është afektuar në mënyrë shumë negative arritja potenciale e misionit të FF. Siç u pa nga diskutimet, vërehej se nuk ishte në spektrin e kompetencave të FF që të kontribuojë në mënyrë efektive në ndryshimin e strukturës organizative që caktohet në nivel të bordit të universitetit. Struktura e përgjithshme e UP duket se në mënyrë negative në rrjedhën e informacionit, si dhe në transparencën e proceseve të vendim-marrjes. Problemet konkrete në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e FF do të cekën në kapitujt në vijim, veçanërisht sa i përket temave të Punës Kërkimore dhe Ndërkombëtarizimit.

Rekomandimet në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e FF do të duhej adresuar në nivel të bordit të UP. Duke qenë se nuk është brenda kompetencave të FF që të ndryshojë në mënyrë aktive strukturën e dhënë të njësisë organizative, rekomandimi për t'u fokusuar në modulet fleksibile dhe të përmirësohet bashkëpunimi në mes departamenteve dhe fakulteteve në nivel akademik dhe administrativ, mund të shërbejnë vetëm si ide udhëzuese. Megjithatë, FF nuk do të duhej të heqë dorë nga synimet për të zhvilluar një strukturë më të fuqishme që ka mbivendosje ose të

paktën një qasje me mbivendosje praktike. Në mënyrë që të zbatohen ato, nevojitet një përmirësim i marrëdhënieve me rektoratin dhe senatin e UP.

3. Personeli i Fakultetit

Gjetjet dhe Rekomandimet

Dëshmitë e ofruara gjatë VNI tregojnë se personeli akademik dhe administrativ i FF është i përkushtuar në mënyrë aktive dhe është mjaft i motivuar për të përmbushur misionet e tyre. Megjithatë, ende duhet të merret në konsiderim detyra e ngritjes së mëtejme të personelit të nevojshëm në mënyrë që të garantohet përmbushja e standardeve të larta administrative dhe akademike dhe kjo duhet të konsiderohet si një nga synimet kryesore me të cilat duhet të përballet FF.

Siç është cekur në RVV, poashtu edhe në bisedat, Menaxhmenti i FF dëshiron t'i marrë në konsiderim të gjitha masat e mundshme për të përmirësuar çështjet që kanë të bëjnë me personelin. Nismat e veçanta siç janë fokusi më i fuqishëm në bashkëpunimet ndërkombëtare, bursat për hulumtues premtues dhe fillimi me disa studime të nivelit të doktoratës, të gjitha këto janë përmendur, megjithëse nuk është bërë evidente një strategji e përgjithshme për ngritjen e mëtejme të personelit. Siç është cekur tashmë në lidhje me Menaxhmentin dhe Organizimin, FF edhe në këtë raport është ndeshur me situatën jashtëzakonisht të vështirë duke qenë plotësisht e varur në vendimet e centralizuara të UP. Janë të centralizuara jo vetëm financimi i personelit, por edhe çështja e kontratave. Për këtë arsye, janë mjaft të kufizuara masat që janë në dispozicion të FF për ngritje të mëtejme të personelit dhe rekrutimi. Megjithatë EE duhet të theksojë nevojën për të gjetur një zgjidhje për disa nga problemet kryesore sa i përket personelit, në lidhje me praktikën e të ardhurave të dyfishta apo të trefishta dhe mbajtjes së njëkohshme të disa vendeve të punës (punët shtesë në të shumtën duke qenë jashtë FF) si dhe ngarkesën e lartë të mësimdhënies për personelin e ri, fakt ky që kufizon ngritjen e tyre akademike dhe në këtë mënyrë kufizon aktivitetet hulumtuese në FF.

Rekomandimet e shprehura në Raportin e EE të vitit 2009 në lidhje me nevojën për të ngritur pagat dhe prezantimin e një sistemi të pagesave promocionale përmes pagesës së ndryshme varësisht nga kualifikimet akademike, kjo sipas menaxhmentit të FF duket se është zbatuar brenda mundësive dhe rrethanave që e kanë lejuar atë. Në anën tjetër, zvogëlimi i orëve të mësimdhënies për personelin e ri akademik nuk është zbatuar ende. Nuk është rregulluar ende as çështja e pagesës së dyfishtë/trefishtë, nuk është adresuar në mënyrë strategjike as çështja e inkurajimit të personelit akademik të gjinisë femërore. Në këtë kuptim EE do të donin të theksonin nuk është e njohur aspak ndjeshmëria ndaj dhunës strukturale pasive.

Si rrjedhojë e intervenimit direkt në rekrutim të personelit dhe ndoshta që vlen të ceket më shumë masat për kontrollin e personelit, duket se ato janë të ndikuara shumë pak nga vetë menaxhmenti i FF, EE do të donte të sugjeronte ngritjen dhe zbatimin e strategjive alternative që do të fokusoheshin në të ashtuquajturat "instrumentet e dobëta organizative" që do të adresonin përgjegjësitë e personelit ndaj dhe që do të ndërlidhnin atë me FF. Në këtë kuptim menaxhmentit të FF i kërkohet përsëri të sqarojë dhe të komunikojë misionin e tij, synimet dhe planin zhvillimor si dhe të fokusohet në bashkëpunimin në mes departamenteve në mënyrë interdisiplinare në mënyrë që të promovojë veten si një institucion atraktiv, premtues që ia vlen të besohet dhe të mbështetet nga pjesëtarët e vet dhe sfera publike në përgjithësi.

Duhet të ceket poashtu që RVV nuk përmbante informata të detajuara në lidhje me personelin administrativ. Gjatë gjithë VNI diskutime kanë theksuar se në këtë kuptim ka zhvillime të mëtejme, ka nevojë për një automatizim/digjitalizim të procedurave administrative. EE kishte përshtypjen e fuqishme që personeli mësimdhënës jo vetëm që ishte sfiduar me faktin që duhej të përballonte sfidat e veta akademike, por poashtu edhe me mungesën e strukturave administrative të elaboruara. Strukturat e centralizuara në nivel të rektoratit të UP duket se nuk janë të qasshme aq sa duhet për FF. EE rekomandon një rritje të fuqishme të kompetencave në lidhje me menaxhimin e personelit: duhet të bëhen të njohura të gjitha kontratat e pjesëtarëve të fakultetit jashtë FF dhe ato duhet t'i vihen në dispozicion dekanit dhe udhëheqësve të veçantë të departamenteve, si dhe rektorati nuk do të duhej të lejonte kontrata të tilla pa një konsultim paraprak me fakultetin dhe brenda fakultetit me udhëheqësit e departamenteve. Si rregull i përgjithshëm, pjesëtarët e FF nuk do të duhej lejuar që të mbanin më shumë se një kontratë me orar të plotë brenda ose jashtë UP.

Si rezultat i bisedave me personelin e FF dhe si një hap drejt menaxhimit më të mirë gjinor për ligjërueset dhe hulumtueset femra (plus ndoshta edhe për studente femra) EE i rekomandon FF dhe administratës së UP që të marrë në konsiderim idenë për ngritjen e një kopshti për fëmijë të Universitetit.

4. Financat

Gjetjet dhe Rekomandimet

Siç është cekur në RVV dhe gjatë VNI, politikat financiare dhe buxhetore janë nën kompetencë të organeve ekzekutive të UP. Për këtë arsye menaxhmenti i FF nuk ka në dispozicion mjete të veta financiare dhe i duhet që të mbulojë nevojat e veta përmes rektoratit të UP-së. Menaxhmenti i FF poashtu ceku qëllimin që të bëhet më i pavarur dhe të përmirësojë në këtë mënyrë cilësinë në të gjitha nivelet. Planifikimi buxhetor i FF për 2012 (një pasqyrë e të cilit i është dërguar si rrjedhojë e kërkesës së bërë më 22 qershor, vetëm në shqip) nuk shtrihej edhe në shpenzimet për personelin dhe pagat (që qartësisht janë të kalkuluara dhe të planifikuara vetëm nga rektorati). Aty tregohet se shumica e planifikuar e shpenzimeve është 162.980 euro në vitin 2012. Një e katërta e kësaj shume është shpenzuar në pagesën e rrymës elektrike, në furnizimin me ujë, në ngrohje, etj. Më shumë se 50 000 Euro shkojnë në mirëmbajtje të objektit dhe vetëm afërsisht e njëjta shumë shpenzohet në aktivitetet e ndërlidhura me hulumtime ose aktivitetet e ndërlidhura me mësimdhënien (shpenzimet e udhëtimit: 7500, nevojat e mësimdhënies dhe trajnimit: 15 000, Blerje për Bibliotekën, videosisteme, etj: 20 000, kompjuterë: 10 000).

EE mbështet fuqimisht synimin FF për një pavarësi të pjesshme financiare. Do të duhej futur në përdorim disa fonde të vogla shpesh, edhe para një ristrukturimi të përgjithshëm në nivel universitar. Një shembull i mundshëm vlen për revistën e FF, që nuk do të duhej të varej nga financimi i pasigurt i palëve të treta për secilin publikim. Megjithatë, tashmë është cekur në Raportin e EE të vitit 2009 që një institucion modern universitar duhet të ngrejë një sistem të mirëfilltë të financimit nga palët e treta, edhe pse potenciali për një financim të tillë është sigurisht mjaft i kufizuar në nivel kombëtar. Vetëm mund të përsëritet që përfitimet e mëdha si në nivel financiar ashtu edhe në atë cilësor mund të priten nga një bashkëpunim në hulumtime në bazë vendore dhe ndërkombëtare. EE do t'i kthehet kësaj pike në kapitujt në vijim.

5. Plani zhvillimor

Gjetjet dhe Rekomandimet

Siç është artikuluar tashmë në lidhje me misionin e FF si dhe me organizimin dhe menaxhimin e tij, EE çmon përpjekjet e ndërmarra në shpjegimin e zhvillimit dhe një strategji të qëndrueshme për programet e veta të studimit dhe përmirësimin e tyre të mëtejme. Poashtu është cekur tashmë që sa i përket EE suksesi i procedurave të tilla do të varet në një masë të madhe në rritjen e bashkëpunimit brenda departamenteve të FF si dhe brenda fakulteteve tjera të UP. Nismat e ndërmarra tashmë në këtë drejtim, meritojnë një vlerësim të veçantë dhe rekomandohet fuqimisht që ato të vazhdojnë. Në këtë kuptim, EE do të donte të ritheksonte rekomandimin e cekur në raportin e EE të 2009 që të shpjegohet më tej (brenda Këshillit të Fakultetit dhe zyrës së Dekanit) sa i përket:

- Ø Plani strategjik i zhvillimit në lidhje me ngritjen e burimeve njerëzore që ka të bëjë me personelin akademik dhe strategjik;
- Ø Plani strategjik i zhvillimit në lidhje me ndërkombëtarizimin dhe mobilitetin për personelin akademik dhe studentët;
- Ø Plani strategjik i zhvillimit në lidhje me punën kërkimore;
- Ø Plani strategjik i zhvillimit në lidhje me përpilimin e kurrikulës.

EE thekson karakterin strategjik që planet e cekura do të duhej të kishin, kjo duke marrë parasysh përshtypjen e krijuar se në përgjithësi ka një mungesë në lidhje me planifikimin strategjik konsistent. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në planifikimin e zhvillimit strategjik është jashtëzakonisht e rekomanduar.

6. Menaxhimi i Cilësisë

Gjetjet dhe Rekomandimet

Siç mund të vërehet në RVV, menaxhmenti i FF i është përkushtuar që nga raporti i EE i vitit 2009 sqarimit të pyetjeve të ngritura nga ai raport sa i përket menaxhimit të cilësisë së FF. Menaxhimi i Cilësisë në nivel qendror edhe këtu është nën përgjegjësinë e menaxhmentit të UP, përderisa në nivel të FF ajo është nën kompetencën e pro-dekanit për arsim.

Si rrjedhojë e financimit të Komitetit të Sigurimit të Cilësisë në nivel të UP dhe në përputhje me gjetjet e VNI, është punësuar me orar jo të plotë një koordinator për zhvillim akademik dhe atë për gjithë FF. Koordinatori duket se është tej-ngarkuar me detyra (ECTS, transferimi i ECTS, kurrikula, çështjet e përgjithshme të departamentit, komunikimi) që duhet t'i përmbush, përderisa e gjithë fusha paraqet vetëm një pjesë të vogël të përshkrimit të punës së tij (përveç detyrave të tij akademike). Pagesa poashtu është minimale, sipas koordinatorit të FF ajo arrin vlerën prej vetëm 70 euro në muaj.

Të dhënat në lidhje me cilësinë që mblidhen përmes instrumenteve të vlerësimit – pyetësorëve për personelin akademik, për personelin administrativ dhe studentët – duket se kufizojnë mundësinë për zbatimin e vazhdueshëm të tyre dhe për një analizë sistematike. Kjo duket se vlen edhe në lidhje me vlerësimin e mësimdhënësve dhe të mësimit për lëndë të veçanta siç është paraparë të ndërmerret në bazë semestrash. Të paktën sipas perceptimit të studentëve, këto vlerësime nuk zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme.

Planet e aktiviteteve janë si rezultat i vlerësimeve të cilësisë dhe si bazë për përmirësimin e cilësisë (siç është referuar në RVV), ato nuk janë të kapshme për EE. Në përgjithësi është për t'u vënë në dyshim efikasiteti i menaxhimit të cilësisë, sepse ai duket se fokusohet vetëm në një vlerësim të vetëm, në vend se të ketë një kornizë kryesore që do të shërbente si mjet i nevojshëm për punë të vazhdueshme në lidhje me programet studimore dhe aktivitetet hulumtuese. Menaxhmenti i FF duket se e konsideron vlerësimin e cilësisë si një mjet kontrolli, përderisa EE rekomandon që ai të fokusohet në potencialin e vet vlerësues.

7. Puna Kërkimore dhe Ndërkombëtarizimi

Gjetjet dhe Rekomandimet

Siç është cekur në mënyrë të ngjashme në gjithë këtë raport, edhe në lidhje me Punën Kërkimore dhe Ndërkombëtarizimin niveli i synuar i zhvillimit strategjik nuk është arritur ende, megjithë faktin se duhet çmuar përpjekjet e ndërmarra. Në këtë drejtim ia vlen të theksohen financimi i Institutit për Studime Sociale dhe Humane si dhe nisma e ndërmarrë sipas RVV për të instaluar një databaza sistematike për publikimet dhe pjesëmarrjet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në takime shkencore nga ana e personelit akademik. Poashtu, rekomandimet për të ndërlidhur punën kërkimore dhe mësimdhënien në një mënyrë më sistematike janë rekomanduar edhe në raportin e EE të vitit 2009 dhe ato duket se në parim janë përfillur nga menaxhmenti i FF.

Megjithatë, zbatimi dhe zhvillimi i mëtejshëm në punë kërkimore dhe ndërkombëtarizim varet në mënyrë të fuqishme në mundësinë për të ofruar materialin e nevojshëm për mbështetje të rrjetëzimit – që duket se nuk është garantuar në masë të mjaftueshme. Në lidhje me mbështetjen materiale, pikë së pari duhet të adresohet gjendja e mjerë e bibliotekës së FF. Tani për tani, biblioteka nuk ofron sasinë/qasjen në literaturën e domosdoshme (libra, revista), e as nuk ofron softuerë dhe harduerë. Është buxhetuar një shumë prej 20 000 eurosh për bibliotekën (poashtu, edhe pse nuk është cekur si e veçantë për video projektorë, etj) por kjo shumë nuk do të jetë e mjaftueshme për të zgjidhur problemin e rëndë nëse një sasi e vogël e këtyre fondeve i dedikohen blerjes së librave dhe të materialeve mësimore. Një shumë e ngjashme apo edhe më e madhe do të duhej dedikuar në secilin vit në vijim blerjes së librave dhe materialeve të mësimiit elektronik. Një shumë e ngjashme apo edhe më e madhe do të duhej dedikuar në secilin vit në vijim deri në riakreditimin e radhës, vetëm blerjes së librave. Tani për tani, biblioteka jo vetëm që nuk punon sipas sistemit modern të katalogimit (OPAC), por aty nuk ka kurrfarë katalogu! Kjo gjendje e rëndë është plotësisht e papranueshme dhe e dëmton rëndë efikasitetin e studimeve në të gjitha nivelet. EE rekomandon fuqimisht që kjo gjendje të ndryshojë sa më shpejt. Për të ndërmarrë këtë hap, janë të nevojshme disa shpenzime shtesë në harduer dhe softuer, por para së gjithash ka nevojë për një përkushtim më i madh ndaj kapitalit njerëzor (bibliotekarëve) dhe motivimit të tyre të mëtejshëm nga ana e udhëheqjes së FF. Një katalogizim i pjesshëm apo i plotë mund të bëhet në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare dhe atë Universitare. Nuk është për t'u mirëpritur që në Këshillin e FF të përbërë nga 25 anëtarë nuk ka asnjë përfaqësues të bibliotekës (pa cekur fare as organizmat e ngjashëm). Jo vetëm në këtë drejtim, biblioteka do të duhej të gëzonte një vend më të shquar në planifikimin strategjik të FF.

Sa i përket rrjetëzimit (detyrë kjo e një rëndësie të madhe që i mundëson qasje në botën shkencore dhe në këtë mënyrë paraqet si një premisë bazike për një orientim ndaj zhvillimit të punës kërkimore) duket se ende mungon një strategji e fokusuar. Megjithëse janë ngritur disa projekte ndërkombëtare, duket se mungon plotësisht, apo të paktën nuk i është komunikuar studentëve një platformë e përgjithshme informuese në këtë drejtim. Bazuar në bisedat me përfaqësuesit e departamenteve të veçanta, gjatë viteve të shkuara Fondi Kombëtar Shkencor do të duhej të kishte ofruar mbështetje ndaj disa projekteve po që se do të ishte aplikuar në kushtet e përcaktuara. FF do të duhej ta konsideronte si detyrë të veten që t'i komunikonte

studentëve të vet nevojën për të aplikuar në konkurse të ngjashme në nivelin e tyre. Po e njëjta vlen për përmirësimin e domosdoshëm të aftësive gjuhësore, që do të duhej fuqizuar dhe do të duhej kërkuar nga ata. Në këtë kuptim, FF do të duhej të ngrinte kërkesën dhe në këtë mënyrë do të sfidonte studentët e vet që të përdorin gjuhë tjera përveç shqipes me qëllim të ndërkombëtarizimit të vet të ardhshëm. Gjatë takimit me studentë, nga 17 studentët e pranishëm, vetëm katër nga ta deklaruan se janë në gjendje që të lexojnë tekste në të paktën një gjuhë të huaj (njëri lexonte gjermanisht dhe anglisht, dy të tjerë vetëm anglisht, kurse i katërti vetëm turqisht). Kjo do të kufizojë perspektivën e tyre të punësimit, si dhe do të kufizojë në mënyrë të rëndë përfshirjen e tyre në projekte ndërkombëtare. Pjesëtarët e fakultetit do të duhej të përfshinin më shumë studentë (me njohje të gjuhëve të huaja) në projektet e tyre ndërkombëtare dhe në kërkimin aktiv të mundësive të reja për zhvillim të ndërkombëtarizimit.

EE sugjeron për rritje të vazhdueshme sistematike të orientimit drejt mësimit të njohurive të gjuhëve të huaja brenda programeve të ndryshme të studimit, kjo ceket si rekomandim i fuqishëm: studentët që fitojnë kredi në gjuhë të huaja (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht ose në një gjuhë që flitet në fqinjësi të Kosovës) qofshin ato në lëndë të veçanta që jepen në FF, ose përmes pjesëmarrjes në lëndët e dhëna në FF, atyre do të duhej t'i jepeshin dhe t'i njiheshin ato kredi brenda programeve të FF.

Si rrjedhojë e raportit të tanishëm, EE ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e financimit nga palët e treta. Kjo mund të përsëritet edhe një herë dhe të rekomandohet fokusimi në zhvillimin strategjik të projekteve vendore dhe ndërkombëtare që janë të një rëndësie shumë të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të FF.

II) Programet e studimit në përgjithësi

Siç është cekur më lart në lidhje me Menaxhimin dhe Organizimin tani për tani FF përbëhet nga 8 departamente që ofrojnë studime sipas nivelit të indikuar:

- Ø Departamenti i Filozofisë (BA, MA, në proces të riakreditimit)
- Ø Departamenti i Historisë (BA, MA, PHD, në proces të riakreditimit)
- Ø Departamenti i Pedagogjisë (BA, MA, PHD, në proces të riakreditimit)
- Ø Departamenti i Sociologjisë (BA, MA, PHD, gjatë VNI të datës 19 qershor nuk u trajtua çështja e riakreditimit)
- Ø Departamenti i Shkencave Politike (BA, MA)
- Ø Departamenti i Psikologjisë (BA)
- Ø Departamenti i Etnologjisë (BA)
- Ø Departamenti i Punës Sociale (BA)

Siç është cekur tashmë, EE çmon përpjekjet e ndërmarra në drejtim të shpjegimit të zhvillimit me një strategji të qëndrueshme për programet e veta studimore dhe për përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. Poashtu, është cekur tashmë që sipas EE suksesi i këtyre procedurave do të varet në masë të madhe nga zbatimi i rekomandimeve të dhëna në këtë raport, veçanërisht sa i përket:

- Ø ngritjes së bashkëpunimit në mes departamenteve të fakultetit, poashtu edhe brenda fakulteteve të tjera të UP;
- Ø planit zhvillimor strategjik në përgjithësi dhe ndërlidhjes së tij me punën kërkimore, me ndërkombëtarizimin dhe me mobilitetin;
- Ø përpilimin e moduleve interdisiplinare të bazuara në bashkëpunimin brenda dhe në mes fakulteteve.

Siç kanë cekur edhe EE në raportin e 2009, do të duhej përpiluar dhe shpjeguar një deklaratë më e gjatë që do të ndikonte natyrën e përgjithshme dhe synimet e secilit program studimor, përmes saj do të specifikoheshin synimet e tentuara në lidhje me arsimin dhe punën hulumtuese, por poashtu edhe në lidhje me pritshmëritë profesionale të studentëve. Procesi i rekomanduar i diferencimit poashtu aplikon dizajnin në njërin anë studimet BA, e në anën tjetër ato MA dhe PhD.

Gjetjet dhe rekomandimet e EE pararendës do të artikulohen në lidhje me programet e vetë-studimit që duhet të akreditohet gjatë këtij raporti të vlerësimit, me një fjalë:

- Ø BA në Filozofi;
- Ø BA, MA dhe PhD në Histori
- Ø BA, MA dhe PhD në Pedagogji.

III) Programet e studimit në detaje

1. Filozofi (BA)

1.1 Gjetjet e Përgjithshme

Thënë në përgjithësi, programi Bachelor në Filozofi pranë Departamentit të Filozofisë është në përputhje me deklaratën e misionit të Fakultetit të Filozofisë dhe me parimet e punësimit.

Bisedat me pjesëtarët përgjegjës akademikë dhe me studentët gjatë VNI kanë dëshmuar në mënyrë të qartë raportin që funksionon mirë në mes të studentëve dhe profesorëve të tyre, kjo në të dyja drejtimet. Studentët janë të kënaqur me lëndët mësimore që iu ofrohen atyre në kontekst të programeve studimore dhe me mënyrën se si ato prezantohen nga ana e mësimeve të tyre akademikë. Gjatë takimit me studentë nga departamente të ndryshme të Fakultetit, studentët e filozofisë ishin të motivuar në mënyrë të veçantë dhe ishin aktivë gjatë bisedës. Megjithë faktin se diploma e tyre bachelor nuk është njohur në mënyrë të duhur në tregun e punës dhe se atyre u duhet të vazhdojnë arsimin në mënyrë të mëtejme në institucione tjera, ata ishin mjaft të kënaqur me studimet e tyre dhe dëshmuuan gjatë diskutimit të çështjeve se kanë aftësi të mendimit kritik.

Përveç shumë arritjeve dhe rezultateve pozitive të Departamentit të Filozofisë, takimi bashkëbisedues me personelin mësimeve vuri në pah disa mangësi siç janë:

- shumë orë mësimi, veçanërisht për asistentë profesorët (10 në javë);
- mungesë e përgjithshme e personelit mësimeve;
- numër i tepërt i studentëve të regjistruar;
- mungesë e mbështetjes financiare adekuate për punë kërkimore.

Diskusimet gjatë takimit me studentët indikuan dy mangësi kryesore:

- njohuri të pamjaftueshme të gjuhëve të huaja;
- vlerësim i cilësisë i pamjaftueshëm për mësimeve përmes pyetësorëve për studentë dhe mjeteve të tjera për sigurimin e cilësisë;

1.2 Gjetjet në lidhje me çështjet e punës kërkimore

Në përputhje me misionin e FF, është fakt me rëndësi që Departamenti tashmë ka krijuar kontakte të fuqishme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimeve me komunitetin shkencor jashtë vendit dhe fakti që anëtarët e Departamentit kanë zhvilluar projektet e tyre kërkimore. Por, EE vërejtë se ka një mungesë të mbështetjes financiare sistematike për projektet kërkimore. As Universiteti dhe Fakulteti, as Qeveria nuk kanë zhvilluar një strategji për financim të rregullt institucional të kërkimeve shkencore. Kur u pyeten në lidhje me financimin e punës kërkimore, përfaqësuesit e Departamentit të Filozofisë u përgjigjën se ata janë të interesuar në hulumtimet e filozofisë dhe implikimeve të saj socio-kulturore, por kjo është më

shumë aktivitete individual prej entuziastësh se sa një strategji e planifikuar në mënyrë të rregullt nga FF.

Rekomandimet në lidhje me çështjet e punës kërkimore

Departamenti do të duhej të zhvillonte një strategji të qartë të kërkimeve shkencore, që do të kishte shans të mirë të fitonte financim nga palët e treta në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si rrjedhojë e faktit që posedon hulumtues të arsimuar mirë jashtë vendit me një listë publikimesh që arrin pritshmëritë ndërkombëtare. Departamenti i Filozofisë do të duhej t'i propozonte FF, Universitetit dhe Qeverisë së Kosovës që të krijojë një mbështetje të rregullt për kërkimet shkencore. Për zhvillimin e mëtejshëm është jetike që Departamenti të shfrytëzojë dhe të koncentrojë resurset mësimdhënëse në mënyrë që të fitojë mjetet e nevojshme financiare që të ndërlihdë personelin akademik në mënyrë të qëndrueshme. Pjesëtarët e FF që pranojnë fondet kërkimore duhet të shpërblehen financiarisht dhe institucionalisht për suksesin e tyre. Atyre duhet t'u mundësohet të marrin pushim me leje në mënyrë që të përkushtohen në punën kërkimore të tyre.

1.3 Gjetjet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar

Departamenti i Filozofisë ka krijuar bashkëpunim të qëndrueshëm me disa universitete dhe institucione ndërkombëtare, në veçanti me ato në Francë, Austri, Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, etj. Ky fokus i respektueshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar kërkon njohuri adekuate të gjuhëve të huaja. Personeli mësimor ka zgjidhur problemin e gjuhës në një mënyrë të shquar. Profesorët flasin gjuhë të huaj në mënyrë të rrjedhshme dhe që të gjithë ata janë të arsimuar pjesërisht jashtë vendit. Ata janë të angazhuar në bashkëpunimet e hulumtimeve shkencore. Por, studentët nuk shfaqin njohuri të theksuara të gjuhëve të huaja. Në takimin me studentë, nga i gjithë grupi i FF vetëm 20% konfirmuan se ata janë në gjendje të lexojnë në anglisht, ose në ndonjë gjuhë tjetër të huaj.

Rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gjuhët e huaja

Një detyrë prioritare e Departamentit të Filozofisë është që të përmirësojë nivelin e njohjes së gjuhëve të huaja tek studentët që marrin pjesë në programet e tyre studimore. Pa e zgjidhur këtë problem, Departamenti i Filozofisë nuk do të jetë në gjendje që të japë mësim në një nivel të lartë në fushën e vet në një afat kohor të gjatë. Në këtë kuptim, mund të rekomandohet që Departamenti të bashkëpunojë në mënyrë intensive me FF që të përmirësojë nivelin e njohjes së gjuhëve të huaja. Veç kësaj, mund të rekomandohet që çdo student të obligohet që të ndjek të paktën dy lëndë që mësohen në gjuhë të huaj gjatë programit BA dhe të paktën një lëndë gjatë ndjekjes së studimeve në nivelin MA. Nëse kërkohet që çdo punim i tezës në nivelin BA, MA dhe sigurisht çdo tezë e nivelit të Doktoratës të ketë të përfshirë përmbledhjen në një gjuhë të huaj, një masë e tillë do të ndihmonte në përmirësimin e njohurive të gjuhëve në Departamentin e Filozofisë.

1.4 Gjetjet në lidhje me librat dhe publikimet mësimore

Gjatë VNI në ndërtesën e bibliotekës, anëtarët e EE kanë vërejtur se në shqip janë përkthyer vetëm disa libra të pakta klasike në filozofi. Për këtë arsye, punimet e mëdha të filozofisë klasike nuk janë pjesë e kulturës publike shqipe dhe studentët nuk mund t'i studiojnë ato, nëse ata nuk janë në gjendje që të lexojnë në gjuhë të huaj. Në sallën e leximit, shumica e studentëve i përgatisnin provimet duke lexuar shënimet e marra vetë me dorë. Duke qenë se Departamenti i Filozofisë mëton të fokusojë punën kërkimore në historinë e filozofisë dhe në filozofinë kulturore, paraqitet si detyrë që jo vetëm të përkthehen në shqip disa nga punimet kryesore, klasike të filozofisë, por edhe që ato të komunikohen përmes organizimit të ngjarjeve publike në mënyrë që të diskutohet përmbajtja e tyre me publikun. Do të jetë e nevojshme që të ndahet kjo njohuri dhe kompetencë jo vetëm brenda komunitetit të universitetit, por edhe në hapësirën publike të kulturës shqiptare. Në këtë kuptim, duhet të vlerësohet fakti që FF ka filluar publikimin e një reviste shkencore në të cilën poashtu do të publikohen punime filozofike.

Rekomandimet në lidhje me librat dhe publikimet mësimore

Duke qenë se librat në lidhje me filozofinë janë jo vetëm në interesin shkencor por edhe në atë kulturor të përgjithshëm, do të jetë e nevojshme që të ofrohet një buxhet për pjesëtarët e departamenti që të përkthejnë në shqip punimet kryesore në fushat e tyre shkencore. Kjo do të duhej të bëhej jo vetëm nga përkthyesit profesionalë, por edhe nga ekspertë akademikë të specializuar në këto degë shkencore. Do të duhej caktuar një shifër fikse vjetore e buxhetit të UP për personelin akademik në formë të pagesave fikse që do të pranoheshin për përkthimin e punimeve të rëndësishme shkencore në fushat e tyre respektive në anglisht dhe në shqip. Nëse filozofia konsiderohet si pjesë e jetës kulturore e një vendi, mbushja e boshllëkut në mes pjesëtarëve të UP dhe atyre të sferës publike paraqet një detyrë të rëndësishme për këtë degë fundamentale të shkencave humanistike. Për këtë arsye, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit që është në dispozicion të departamentit do të duhej shfrytëzuar për organizimin e ngjarjeve publike, kjo në mënyrë që të stimulohet debati publik në lidhje me çështjet filozofike.

1.5 Gjetjet në lidhje me personelin mësimor

Një nga çështjet problematike të gjithë FF është çështja e pagës jo adekuate për personelin akademik për punën që ata kryejnë. Megjithë faktin se pagat janë rritur në mënyrë nominalë në vitet e fundit, ato nuk janë të mjaftueshme për punën e vështirë të profesorëve që duhet të mbajnë mësim në lëndë të ndryshme dhe të kenë punë jashtë orari në mësimdhënie. Gjatë VNI mësimdhënësit treguan për këtë problem dhe shpjeguan faktin se të punësuarit në pozitat akademike të ulëta/të mesme nuk marrin pagesë të duhur në raport me punën, të cilën ata e bëjnë. Problem tjetër është numri tepër i madh i orëve të mësimi, veçanërisht për asistent profesorët.

Rekomandimet në lidhje me personelin mësimdhënës

Në mënyrë që të përmirësohet kjo situatë, fillimisht është e domosdoshme që të rriten rrogat dhe të krijohet dhe të zbatohet një plan i qartë i karrierës për të punësuarit, në të cilin do të reflektoheshin kualifikimi akademik, lista e publikimeve, praktika e mësimdhënies, puna kërkimore dhe njohja e gjuhëve në rrogën me të cilën ata do të paguheshin. Së dyti, personeli mësimor nuk do të duhej të jepte mësim në shumë lëndë të ndryshme dhe shumë orë mësimi, në mënyrë që ata të kenë kohë të mjaftueshme për hulumtimet e tyre dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar. Sigurisht që FF do të duhej të ngrinte numrin e personelit mësimor në përputhje me numrin e studentëve.

1.6 Gjetjet në lidhje me programet studimore dhe caktimin e ECTS

Duke qenë se informatat e dhëna në planin studimore dhe në programin e studimeve të Departamentit, të dorëzuara në nëntor 2011 në RVV, nuk janë përkthyer në mënyrë të duhur në anglisht dhe kanë përmbajtur shumë gabime dhe konfuzion që është vërejtur nga pjesëtarët e departamentit, EE ka hasur vështirësi të mëdha në vlerësimin e detajuar të përmbajtjes dhe cilësisë së programit studimor. Por në përgjithësi, EE vlerëson se programi Bachelor në Filozofi është krijuar në mënyrë të duhur. Struktura e programit është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe jep mundësi të mjaftueshme për punë të pavarur, për reflektim dhe analizë. Në përgjithësi, programi BA në Filozofi është duke u realizuar mirë. Ai bazohet në konceptin didaktik kryesor që është komunikuar në mënyrë të duhur personelit mësimor dhe është pranuar nga ky i fundit. Kriteret e procesit të Bolonjës janë zbatuar dhe studentët kanë shprehur miratim të gjerë të programit BA në Departamentin e Filozofisë. Në diskutimet me anëtarët e personelit akademik, është theksuar që caktimi i kredive ECTS në semestrin e fundit do të mund të kishte ndryshuar, në mënyrë që t'i kushtonte më shumë rëndësi punës në tezën e BA.

Rekomandimet në lidhje me programet studimore dhe me caktimin e ECTS

Megjithë faktin se në përgjithësi caktimi i kredive ECTS është i duhur dhe kuptimplotë, EE konsideron se do të kishte kuptim sikur të rritej numri i kredive ECTS të përcaktuara për shkrimin e tezës BA, në mënyrë që të theksohej rëndësia e shkrimit akademik profesional. Ne do të donim të përsërisnim sugjerimet e caktimit të kredive, të cekur në raportin pararendës, 12 ECTS për tezën e BA.

Rekomandim Përfundimtar

Programi BA në Filozofi si i tillë dhe duke pasur parasysh infrastrukturën e hasur gjatë Vizitës në Institucion si dhe pas shqyrtimit të dokumenteve, ky program plotësisht e arsyeton vlerësimin pozitiv të Departamentit të Filozofisë dhe të programit BA në Filozofi.

2. Histori (BA/MA/PHD)

2.1 Vërejtje të përgjithshme

Gjetjet në lidhje me tri programet e studimit në histori të ofruar nga Departamenti i Historisë i FF, janë bazuar në materialin e vënë në dispozicion të EE nga ana e AAK, në veçanti përmes RVV, CV të disa nga personeli akademik dhe të përshtypjeve të fituara gjatë VNI më 19 qershor, kur EE takoi Prof. Ass. Dr. Muhamet Mala, Prof. Dr. Gazmend Rizaj dhe Ass. MA Albina Drançolli, si përfaqësues të Departamentit. Gjatë një pjese të madhe të takimit, Basri Muja nga AAK ishte poashtu prezent. Përderisa diskutimet i referoheshin të tria programeve të ofruara nga departamenti (BA; MA; PhD), ai u fokusua në një shembull nga studimet bachelor. Takimi me studentë të FF, pesë nga të cilët vinin nga programi BA në Histori dhe takimi me personelin e fakultetit (ku ishte prezent një ligjërues nga departamenti i Historisë) dhanë përshtypje shtesë në pamjen e krijuar.

Sa i përket materialit që EE iu dha përmes AAK, duhet thënë se materiali në lidhje me lëndët në programin BA ishte përpiluar në mënyrë të ngutshme dhe përkthimi i tij në anglisht ishte bërë edhe më me nguti: kishte shumë gabime dhe pjesërisht dokumenti ishte i pakuptueshëm nëse nuk ke një njohuri paraprake të shqipes. Përpilimi i dokumentit ishte i dobët dhe do të mund të shërbente si një shembull i keq po t'i jepej studentëve dhe t'u tregohej atyre se si nuk duhet të përpilohet një shkrim akademik.

Në departament janë 16 ligjërues të rregullt, 6 me orar jo të plotë që vijnë jashtë UP dhe 3 ligjërues nga fakultetet tjera të UP. Tri programet janë prezantuar si një tërësi duke krijuar një rreth të arsimimit akademik. Para se të shkohet në detaje, është për t'u mirëpritur fakti që departamenti synon që të mbulojë të tria nivelet e studimit.

2. 2 Programi BA në Histori

2.2.1 Gjetjet e Përgjithshme

Thënë në përgjithësi programi Bachelor i Historisë në Departamentin e Historisë është në përputhje me deklaratën e misionit të Fakultetit të Filozofisë dhe me principet e punësimit – përveç faktit që një BA e thjeshtë në shumicën e herëve nuk do të jetë e mjaftueshme për të gjetur punësim që ka të bëjë me programin e studimit.

Një pikë e dobët themelore ka të bëjë me pretendimin (e cekur në Synimin dhe Profilin e Programit, RVV, f. 40) që programi ka një "karakter të përgjithshëm të balancuar me nivelin rajonal dhe atë vendor, pa cekur asnjë prioritet". Përveç faktit që disa prioritete duhet të caktohen në gjithë programin, aq më shumë duke qenë se lëndët e përgjithshme kanë fokus të fortë në historinë e shqiptarëve dhe proto-shqiptarëve. Të pasurit e fokusit në historinë kombëtare paraqet një tipar të programeve të studimit gjithandej në Evropë dhe nuk paraqet ndonjë problem në vete. Por, problematik është fakti që nuk ka një vetëdijësim në lidhje me orientimin e programit dhe në disa raste edhe brenda programit BA të dhënë, ky orientim duket se ka rrjedhoja problematike. P.sh brenda lëndës "Histori Antikiteti e Shqiptarëve" (që nënkupton edhe tema nga arkeologjia, disa studime mesj re, etj) është e nevojshme të përfshihet diskutimi në lidhje me hipotezat e ndryshme në lidhje me vazhdimësinë ose mungesën e saj në mes Ilirëve dhe atyre të Arbrit, kjo brenda përkrahimit të lëndës dhe praktikimit të saj. Në disa lëndë ka sasi të papranueshme të romantizmit kombëtar. P.sh lënda 20, "Perandoria e Bizantit dhe Shqiptarët": Perandorët me prejardhje Ilire kanë bërë përpjekje të ndalin depërtimin e sllavëve, kjo në fakt paraqet një paramendim të thjeshtë, dhe përderisa kishte zona të banuara me Ilirë në atë kohë, të folurit për "hapësira të trashëguara nga shqiptarët" për këtë periudhë paraqet një shpërdorim të terminologjisë që duhet të rregullohet në mënyrë urgjente në të ardhmen (RVV, f. 56). Brenda përpjekjeve për të fuqizuar përfshirjen e historisë shqiptare në ngritjen e përgjithshme, gjatë diskutimit me përfaqësuesit e departamentit është arritur pajtim që të transferohen lëndë të veçanta, p.sh lënda 5 (Historia e Shqiptarëve Antikë) në semestrin e dytë, në këtë mënyrë ajo shndërrohet lënda nr. 6 dhe transferimi i lëndës në "Historinë e Greqisë dhe Romës" nga semestri i dytë në atë të parin. Është arritur pajtim që terminologjia e vjetruar në lidhje me "Historinë Botërore" (që është gjithçka përtej rajonit) do të duhej shndërruar në "Histori e Evropës dhe e Botës", duke qenë se rreth 80 ose 90 përqind e lëndës trajton historinë e Evropës. Ky do të paraqiste kontributin e parë për të fuqizuar aspektet që tani për tani janë të shpërfillura të historisë së Evropës. Në lëndët që do të ofrohen në të ardhmen, do të ishte e këshillueshme që të arrihet një pasqyrim më i mirë në lidhje me Perandorinë Osmane dhe me Jugosllavinë, qoftë si shtete dhe si shoqëri, duke mos filluar që në fillim me fokusimin në shqiptarë në atë kontekst, siç është praktikë tani brenda programit të studimeve.

Diskutimet me pjesëtarët përgjegjës akademikë dhe me studentë gjatë VNI dëshmuar se raporti në mes studentëve dhe ligjëruesve/profesorëve funksionon mjaft mirë në të dyja drejtimet. Studentët e pranishëm në takim ishin të kënaqur me lëndët të cilat iu ofroheshin atyre në kontekstin e programeve të studimit dhe me mënyrën se si ato janë të prezantuara nga mësimmshënësit akademikë.

Përveç disa arritjeve mjaft pozitive dhe rezultateve të Departamentit të Historisë, diskutimet në takim në nivel të departamentit dhe me personelin mësimdhënës kanë dëshmuar në lidhje me disa mangësi siç janë:

- shumë orë mësimi për asistent profesorët (10 në javë);
- mungesë të mbështetjes së duhur financiare për punë kërkimore.

Diskutimi në takimin me studentë indikoi në dy mangësi kryesore:

- Një mangësi e shprehur në lidhje me njohjen e gjuhëve të huaja mes studentësh: me përjashtim të nismave personale të individëve;
- Një vlerësim të pamjaftueshëm të cilësisë së mësimdhënësve përmes pyetësorëve të studentëve dhe mjeteve tjera të sigurimit të cilësisë.

2.2.2 Gjetjet në lidhje me çështjet kërkimore

EE ka vërejtur një mungesë sistematike të mbështetjes financiare për projektet kërkimore, por poashtu një orientim të panevojshëm ndaj projekteve të kushtueshme jashtë vendit.

As Universiteti e as Fakulteti apo Departamenti nuk duket se kanë të zhvilluar një strategji për financim të rregullt institucional ose që ndërlidhjet me kërkimin shkencor; projektet në të shumtën janë fryt i aktivitetit individual e jo si rezultat i një strategjie të rregullt të planifikimit nga ana e Departamentit.

Rekomandimet në lidhje me çështjet kërkimore

Departamenti do të duhej të zhvillonte një strategji të qartë të kërkimit shkencor, që do të përmirësonte shansin e fitimit të financimit nga palët e treta qoftë në nivel vendor apo atë ndërkombëtar. Departamenti i Historisë do të duhej t'i propozonte FF, Universitetit dhe Qeverisë së Kosovës që të krijojnë një mbështetje të rregullt për kërkimet shkencore. Për zhvillimin e ardhshëm të Departamentit është jetike që të shfrytëzohen dhe të përqendrohen resurset mësimore në mënyrë që të merren mjetet e nevojshme financiare për të ndërlidhur personelin akademik në një mënyrë të duhur. Anëtarët e personelit të FF që janë duke pranuar fonde për punë kërkimore duhet të shpërblehen në aspekt financiar dhe institucional për suksesin e tyre. Atyre duhet t'u mundësohet mundësia e marrjes së pushimeve me pagesë në mënyrë që të fokusohen në punën e tyre kërkimore. Duhet zvogëluar barra e mësimdhënies për hulumtues të rinj, si dhe duhet zhvilluar një strategji për të evituar kontratat e dyfishta e të trefishta të personelit. Duhet të ndërmerren përpjekje nga ana e hulumtuesve që të zhvillohet njohuri në lidhje me njohjen e gjuhëve evropiane në fushën e historisë, siç janë gjermanishtja, frëngjishtja dhe anglishtja, ose ato që janë të ndërlidhura në mënyrë specifike me historinë e Ballkanit, siç janë Osmanishtja (Turqishtja) dhe (mes hulumtuesve të rinj) edhe gjuhët e sllavëve të jugut, duhet të pritet nga ta njohja e tyre.

2.2.3 Gjetjet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar duket se është i dobët përveç bashkëpunimit me vendet tjera shqipfolëse. Një fokus më i zgjeruar i bashkëpunimit ndërkombëtar

kërkon një njohje adekuate të gjuhëve të huaja nga ana e personelit dhe e studentëve. Mungon një strategji në lidhje me kontaktet përtej vendeve shqipfolëse dhe me bashkëpunimin përtej rajonit.

Rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gjuhët e huaja

Një detyrë me prioritet e Departamentit të Historisë së FF do të duhej të ishte përmirësimi i njohjes së gjuhëve të huaja nga personeli dhe studentët. Pa e zgjidhur këtë problem me njohjen e gjuhëve, Departamenti i Historisë nuk do të jetë në gjendje që të ofrojë mësim modern në fushën e vet të studimit. Në këtë kuptim, mund të rekomandohet fuqimisht që departamentet të bashkëpunojnë në mënyrë intensive me FF që të përmirësojnë njohjen e gjuhëve të huaja.

2.2.4 Gjetjet në lidhje me librat dhe materialin mësimor

VNI në ndërtesën e bibliotekës shpërfaq një mungesë të teksteve themelore të historisë goftë edhe në lidhje me tekstet në shqip, pa përmendur një mungesë të madhe të teksteve në historinë e Evropës Juglindore në gjuhët kryesore evropiane. Përshkrimi i lëndës i disa lëndëve kishte mungesa në lidhje me ndarjen e qartë në mes teksteve akademike dhe jo akademike që kërkohet të lexohen (p.sh: teksti joakademik dhe tejet i vjetruar i Edvin Jacques ishte cekur shpesh në përkthimin e bërë në shqip, kjo shkaktoi frikën mes EE që studentët nuk do të jenë në gjendje që ta dallojnë atë nga literatura më e bazuar).

Rekomandimet në lidhje me tekstet dhe publikimet mësimore

Duhet të përmirësohet fondi i bibliotekës, nga personeli dhe studentët duhet të pritet që të shfrytëzojnë tekste në gjuhë të tjera përveç shqipes. Tekstet joakademike nuk do të duhej përfshirë në listën e leximit pa dhënë një koment në lidhje me këtë.

2.2.5 Gjetjet në lidhje me Personelin Mësimor

Një çështje problematike në gjithë FF paraqet ngarkesa tepër e madhe me shumë orë mësimi, veçanërisht për asistent profesorët. Në anën tjetër, orët e mësimit për profesorët e rregullt (që tani është 6 orë në javë) do të mund të paraqisnin kushte të mira për punë kërkimore dhe mësimdhënie, numri i tyre është mjaft i vogël kjo krahasuar me praktikën ndërkombëtare. Efekti negativ i kontratave të dyfishta apo edhe të trefishta në ligjërues të veçantë ndihet edhe në këtë departament. Por, shifra e dhënë nga përfaqësuesit e Departamentit se 30 përqind e personelit kanë kontrata të tilla, paraqet një indikacion se në kolegjet private nuk ka kërkesë për historinë. Një kërkesë e tillë në shumicën e rasteve shtrihet në fushën e ekspertizës që është fituar në fushat e programeve të tjera studimore, siç janë studimet e politikave.

Një tipar tjetër që bie në sy është prezenca e një numri të madh të pjesëtarëve familjar të rinj me personelin e vjetër. Në të ardhmen, departamenti do të duhej të largonte edhe dyshimet më të vogla në atë drejtim, duke i hetuar kandidatët për lidhjet e tyre familjare. Në përgjithësi, ata do të duhej të fillonin karrierat e tyre akademike në institucionet jashtë departamentit.

Rekomandimet në lidhje me personelin mësimdhënës

FF dhe Departamenti do të duhej të zhvillonin një strategji që të lehtësonin barrën e personelit të ri nga detyrat e mësimdhënies.

2.2.6 Gjetjet në lidhje me programet e studimit dhe caktimin e ECTS

Në përgjithësi, EE vlerëson se programi Bachelor në Histori është themeluar në mënyrë të mjaftueshme. Në përgjithësi, struktura e programit korrespondon me standardet ndërkombëtare dhe ofron mundësi për punë të pavarur studimore, për reflektim dhe analizë, edhe pse duket se ka një theks të fuqishëm në ushtrim dhe provime në vend të shkrimit të eseve. Kriteret e procesit të Bolonjës janë zbatuar. Caktimi i kredive ECTS në semestrin e fundit tashmë është ndryshuar në mënyrë që t'i kushtojë rëndësi më të madhe punës në tezën e BA, kjo për dallim nga vlerësimi i fundit i EE. EE sugjeron që të ketë hapa shtesë në këtë drejtim. Këshillohet të ketë caktim të mëtejshëm në këtë drejtim.

Rekomandimi në lidhje me programin e studimeve dhe me caktimin e kredive ECTS

Megjithëse caktimi i kredive ECTS në përgjithësi është i duhur dhe kuptimplotë, EE konsideron se do të kishte kuptim ngritja e numrit të kredive ECTS që do të duhej të jepeshin për tezën BA në mënyrë që të vihej theks në shkrimin akademik profesional. Raporti pararendës sugjeronte 9-12 ECTS për tezën BA, por duke qenë se aftësitë për të shkruar në mënyrë akademike janë të domosdoshme në studimet e historisë, ka një sugjerim që të caktohen të paktën 20 kredi ECTS për tezën në histori (në Universitetin e Regensburgut, tezës i kushtohen 20 përqind e notës së përgjithshme të studimeve, që do të kishte vlerën prej 36 kredive ECTS në një program prej 180 ECTS siç është ai në Prishtinë). Në të njëjtën kohë, kjo tezë do të duhej të ishte më e gjatë se 20 faqet e rekomanduara tani. Një gjatësi prej të paktën 30 faqesh dhe maksimum 50 faqesh do të duhej të merrej në konsiderim, duke marrë për shembull disa universitete në Bavari si model.

Njëkohësisht, duhet të rriten shkëmbimet në departament të elementeve të programit të studimeve: ka lëndë që janë relevante për studentët e historisë, p.sh në Departamentin e Sociologjisë (p.sh. lënda në teorinë e nacionalizmit) ose me institucionet tjera të UP brenda dhe jashtë FF. Në këtë kuptim, një fushë me rëndësi është ajo e njohjes së gjuhëve të huaja që duhet të përmirësohet në bashkëpunim me Fakultetin e Filologjisë, çështje kjo që është cekur tashmë.

Rekomandimi Përfundimtar

Programi BA në Histori në formën që ofrohet tani dhe duke pasur parasysh infrastrukturën e vërejtur gjatë vizitës në institucion dhe pas shqyrtimit të dokumenteve, arsyeton një vlerësim pozitiv të Departamentit të Historisë dhe akreditimin e programit BA në Histori për një periudhë tjetër të plotë prej tre vjetësh.

2.3 Programi MA në Histori

2.3.1 Vërejtjet e Përgjithshme dhe Gjetjet

Shumica e vërejtjeve dhe gjetjeve të programit BA në Histori mund të thuhet se vlejné edhe për programin e studimeve në nivelin MA, në përfundim të të cilit studentëve u jepet titulli Master në Historinë e Kohës Bashkëkohore (Shekulli XIX dhe XX). Dy vërejtje të përgjithshme janë të veçanta për këtë nivel studimesh. E para ka të bëjë me faktin që Departamenti është ankuar në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mungesën e transparencës nga ana e senatit të UP në lidhje me trajnimin e aplikimit për programin e dytë të nivelit të studimeve Master në Histori, është fjala për programin në Historinë e Mesjetës. Në fakt, në parim do të ishte më mirë sikur departamenti të ofronte një gamë më të gjerë të mundësive të studimeve MA, jo siç pretendohet nga departamenti të ofrojë më shumë zgjedhje në programin PhD. Së dyti, siç është cekur në procesin akreditues pararendës, studentët me Master në Histori gjer më tani duket se kanë shanse të mira të punësimit si mësimdhënës në shkolla dhe gjimnaze gjithandej Kosovës. Në raportin pararendës, është theksuar se një shifër prej 50 përqind e studentëve të suksesshëm në nivelin MA në Histori, kanë gjetur vende punë në këtë fushë. Gjatë diskutimeve, AAK ka theksuar disa herë reformën e përgjithshme të arsimit të mësimdhënësve që do të duhej të ristrukturonte gjithë nivelin e shkollimit MA për mësues shkollash, duke e centralizuar atë në një njësi të veçantë arsimit. Eksperti i historisë që ishte në përbërje të EE ekzistues dëshiron të artikulojë nevojën për integrim të lëndëve specifike (siç janë ato nga historia) në atë nivel të planifikuar të arsimit. Kjo do të kontribuonte në një shkallë më të lartë të ndërkëmbimit në mes elementeve të departamenteve ose fakulteteve të sistemit universitar, që është e këshillueshme në të gjitha nivelet e veta.

2.3.2 Gjetjet në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS

Një tjetër vërejtje e veçantë vlen për caktimin e kredive ECTS, duke qenë se caktimi prej 30 kredish ECTS në semestrin e fundit për përgatitjen e tezës së diplomës së Master duket se është i mjaftueshëm duke marrë parasysh rëndësinë e tezës.

Rekomandimi Përfundimtar

Programi MA në Histori në formën që ofrohet tani dhe duke pasur parasysh infrastrukturën e vërejtur gjatë vizitës në institucion dhe pas shqyrtimit të dokumenteve, arsyeton një vlerësim pozitiv të Departamentit të Historisë dhe akreditimin e programit MA në Historinë e Kohëve Moderne (ose MA në Historinë e Kohëve të Reja, siç është përkthyer në mënyrë të gabuar në anglisht, në versionin e RVV) për një periudhë të plotë prej tre vjetësh.

2.4 Programi PhD në Histori

2.4.1 Vërejtjet e përgjithshme dhe Gjetjet

Materiali që ka të bëjë me këtë program studimesh brenda RVV nuk ishte aspak i mjaftueshëm për të vlerësuar të gjitha aspektet e programit.

Programi trevjeçar në histori dallon në mënyrë të duhur nga Programet BA dhe MA duke dhënë një theks më të fortë në historinë e Evropës Juglindore. Megjithatë, ende vërehet fakti që aspektet e historisë kombëtare (shqiptare) janë të përfaqësuara në mënyrë të fuqishme brenda programit dhe një fokus i veçantë do të duhej t'i kushtohej integritit të tyre sa herë që të jetë e mundur në pikëvështrimin e gjithë rajonit. Kjo do të ndihmonte në rritjen e mundësive të punësimit për studentë të PhD në projektet ndërkombëtare ose në universitetet jashtë rajonit. Megjithatë, në këtë kuptim, kërkesa për njohje të gjuhëve që fliten në rajon, përveç shqipes sigurisht do të duhej të paraqiste një parakusht për ngritjen e mëtejme të programit të studimeve.

Personeli mësimdhënës në programin e tanishëm duket se është adekuat, qoftë sa i përket numrit apo edhe përgatitjes akademike. Është për t'u mirëpritur fakti që studimet PhD janë të hapura ndaj të gjitha fushave (ose thënë ndryshe epokave) të specializimit dhe profilit: Histori Antike, Histori Mesjetare (që në këtë rast nënkupton epokën siç janë edhe në tabelë evropiane të periodizimit të historisë, duke vazhduar deri rreth vitit 1500, kurse lëndët që kanë të bëjnë me historinë shqiptare në nivelin BA dhe MA, e definojnë Mesjetën si periudhë që vazhdon deri në fillim të shekullit XIX!), Histori Moderne dhe Histori Bashkëkohore. Por duhet ngritur pyetja nëse lëndët mësimore në semestrin e dytë (RVV f. 162) do të duhej të duhet të ishin të ndërlidhura në mënyrë strikte me temën e disertacionit: do të ishte shumë e vështirë dhe e lodhshme sa i përket resurseve që të ofrohen tri lëndë të ndryshme në secilën fushë, kjo duke pasur parasysh që do të ketë një numër të vogël studentësh në nivelin PhD (8 sipas konkursit të vitit 2012). Numri i përgjithshëm i lëndëve do të duhej reduktuar, duke lënë mundësinë e zgjedhjes në mes tri lëndëve për atë semestër kandidatëve PhD. Semestri i parë është i përshtatur në mënyrë të duhur lëndëve të përgjithshme (metodologjike) që ofrohen.

Viti i dytë i programit do të jetë më problematik në zbatimin e tij praktik, duke qenë se kërkesa kryesore për këta dy semestra është përpilimi i një publikimi të shqyrtuar në nivel kolegësh ndërkombëtarë. Duket të jetë e paqartë nëse ky punim do të shqyrtohet nga shqyrtues ndërkombëtar (ndërkombëtar në kuptimin e Shqipërisë ose Maqedonisë?), por që do të publikohet në shqip në Kosovë ose në ndonjë vend në fqinjësi, ose publikimi i këtij punimi në një vëllim apo revistë ndërkombëtare (dhe jo në shqip). Kjo paraqet një dallim të madh që nuk mund të vlerësohet nga materiali i prezantuar përmes RVV. Sido që të jetë, tani për tani nuk mund të paramendohet se deri në çfarë mase do të kenë ndikim shqyrtuesit kolegialë (duke qenë se nuk janë pjesëmarrës në programin e studimeve) në caktimin e kredive ECTS në këtë pjesë të programit të studimeve.

2.4.2 Gjetjet në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS

Caktimi prej 60 kredive ECTS për secilin vit të studimeve (që nënkupton 60 kredi për tezën dhe mbrojtjen e saj) duket të jetë adekuat, edhe pse transferi prej gati 20 kredive prej dy viteve të para (10 kredi prej secilit vit) në tezë do të dukej të ishte hap më i duhur.

Rekomandimi Përfundimtar

Programi PhD në Histori arsyeton vlerësimin pozitiv të programit. Zbatimi i suksesshëm i programit do të duhej të rivlerësohet gjatë periudhës prej tri vjetësh, dy vjet nga tani.
--

3. Pedagogji (BA/MA/PhD)

3.1 Gjetje të Përgjithshme

Në përgjithësi, të dyja programet në nivelin Bachelor dhe Master në Pedagogji në Departamentin e Pedagogjisë janë në përputhje me deklaratën e misionit të FF. Tani për tani Departamenti i Pedagogjisë ofron studimet në nivelin Bachelor në Pedagogjinë e Përgjithshme (BA) dhe në nivelin Master (MA).

Që nga raporti i vlerësimit të EE në 2009, është bërë një punë e madhe në Departamentin e Edukimit. Janë krijuar tipe plotësisht të reja të programeve të studimit që fokusohen më shumë në pedagogji. Dëshmitë nga diskutimet me personelin treguan për aftësitë dhe gatishmërinë e tyre për të zhvilluar fushën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore në drejtim të mësimdhënies së bazuar në hulumtime. Ngarkesa e tyre do të duhej t'iu mundësonte dhe t'u jepte kohë për të vazhduar me zhvillimin.

Gjatë diskutimeve në VNI, u pa që personeli dhe studentët shprehnin vetëbesim në lidhje me programin e tyre të studimeve. Në takimin me studentë të të gjitha departamenteve, studentët e pedagogjisë dukeshin të motivuar, por nuk ishin edhe aq të bindur nëse programi ishte i mundur në të gjitha rastet. Kjo ishte në përputhje me raportin pararendës të vlerësimit (ER2009).

Në përputhje me përshkrimin e lëndëve në raportin e RVV, ka mjaft lëndë të mira qoftë në programet BA apo MA të Departamentit të Pedagogjisë. Pjesëtarët e personelit dukej se ishin shumë të kualifikuar në fushën e pedagogjisë. Sipas CV të tyre, ata dukej se kishin ekspertizë në mësimin e mësimdhënësve dhe përvojë në përpilimin e programeve që nga faza e para futjes në shërbim e deri në atë të futjes në shërbim si dhe në përcjelljen dhe vlerësimin e punës në terren. Pa asnjë dyshim, ata kanë kompetencë për të përpiluar programe të studimeve universitare dhe përgatitja e tyre i përgjigjet kërkesave për mësimdhënie të bazuar në punë kërkimore dhe në zhvillim ndërkombëtar të departamentit.

Studentët e departamentit duket se ishin të kënaqur me cilësinë dhe metodat e mësimdhënies. Kjo mund të jetë si rrjedhojë e faktit që ata nuk kishin me çfarë t'i krahasojnë ato. Kur ata u pyetën se sa nga ata ishin në gjendje të flisnin në anglisht, vetëm 4 nga 20 (duke përfshirë të gjithë studentët e FF) i ngritën duart. Kjo na bëri ne të EE që të pyesim nëse kjo ishte si rrjedhojë e kërkesave të ulëta të fakultetit në këtë drejtim. Studentët kërkonin më shumë libra në anglisht, kjo është e kuptueshme, por kjo poashtu dëshmon për mundësitë e kufizuara dhe hezitimin e studentëve që të bëjnë më shumë përpjekje në studimet e tyre dhe të ngrinin aftësitë e tyre për të punuar në vende të tjera.

3.2 Gjetjet në lidhje me çështjet e punës kërkimore

Mundësitë e studentëve për punë kërkimore

Programi i studimeve BA përfshin lëndë të mira që garantojnë se studentët do të kenë baza të mjaftueshme të dijeve për studimet e tyre në të ardhme dhe për kryerje të hulumtimeve. Për shembull lëndët mësimore *Metodologjia e Hulumtimit Shkencor* dhe *Hulumtimi Shkencor dhe*

Analiza e të Dhënave (sipas përshkrimit të lëndëve të mësim) ofrojnë një bazë për planifikim dhe zhvillim të hulumtimeve. Megjithatë, këto përshkrime lëndësh mësimore në RVV nuk ofrojnë informata në lidhje me çfarë lloji hulumtimesh do t'i kërkoen studentëve që t'i bëjnë dhe nëse hulumtimet e tyre janë të përfshira në hulumtimet e profesorëve të tyre. Kjo do të mund të paraqiste një nevojë absolute për zhvillimin e traditës hulumtuese në departament. Plani i studimeve nuk tregon se sa janë të mbështetur studentët gjatë studimeve të tyre dhe veçanërisht në lidhje me punën kërkimore. Këshillimi i vazhdueshëm do të duhej të ofrohej në mënyrë automatike.

Poashtu, edhe programi i studimeve në nivelin MA përfshin lëndë të mira mësimore që mund të garantojnë një mësim shumëdimensional që mundëson punësimin në fushën e edukimit si dhe ofron mjetet e nevojshme për kryerje të hulumtimeve. Megjithatë nuk ka një indikacion të qartë se si do të mundësohet garantimi i aftësisë të studentëve për kryerje të hulumtimeve në nivel ndërkombëtar. Kjo duhet të merret parasysh në mënyrë serioze kur të bëhet ripërtëritja e programit të studimeve. Bazuar në programin e studimeve, në diskutimet me personelin dhe me studentët, duket qartë se duhet të bëhet më shumë përpjekje në arsimimin e studentëve që do të ishin të aftë të studionin në anglisht (apo në ndonjë gjuhë tjetër) që do t'i garantonte atyre mundësin për të vazhduar studimet e tyre jashtë vendit dhe të publikojnë në nivel ndërkombëtar. Kjo është shumë e rëndësishme për zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Mundësitë e personelit për hulumtime

Sipas misionit të FF, duket qartë se Departamenti ka krijuar disa kontakte të rëndësishme për punë hulumtuese dhe disa pjesëtarë të personelit janë përfshirë në disa projekte hulumtimi. Megjithatë poashtu duket e qartë se kjo është më shumë e bazuar në baza individuale dhe mungon një strategji e përgjithshme në lidhje me hulumtimet në nivel të Departamentit të Pedagogjisë, apo edhe gjithë FF. Kjo mund të jetë si rrjedhojë e asaj që e vërejtën edhe EE se nuk ka një mbështetje sistematike në departament për punën kërkimore. Puna kërkimore nuk mbështetet nga Fakulteti e as nga Qeveria në çfarëdo mënyre. Diskutimet me pjesëtarët e personelit dëshmuar faktin se nëse ka pjesëtarë të personelit që janë shumë entuziastë në lidhje me hulumtimet, atëherë ata e zhvillojnë këtë aktivitet duke shfrytëzuar kohën e tyre. Mbështetja shtesë mund të vijë nga projektet ndërkombëtare.

Rekomandimet në lidhje me çështjet e kërkimit

Departamenti i Pedagogjisë do të duhej të fillonte ngritjen e proceseve me qëllimin që të krijojë një program të fuqishëm të kërkimeve. Në këtë mënyrë ata do të mund të krijojnë një ekip të fuqishëm hulumtues dhe do të kishin më shumë fuqi kur të aplikojnë për mbështetje financiare. Ata poashtu do të duhej t'i propozonin Fakultetit si dhe UP dhe Qeverisë së Kosovës që të krijojnë një sistem që do të mbështeste në mënyrë të rregullt hulumtimin shkencor. Departamenti do të duhej të punonte në mënyrë të afërt me Ministrinë e Arsimit me qëllim që të sigurojë faktin që ata të jenë të informuar në lidhje me hulumtimet. Hulumtimet janë baza e zhvillimit në të gjitha fushat. Pa programe studimi të bazuara në punë kërkimore dhe pa grupe kërkimore, Departamenti nuk mund të krijojë një njësi të qëndrueshme as në nivel vendor e as në atë ndërkombëtar. Poashtu, departamenti do të duhej të mbështeste personelin mësimdhënës që kanë qenë në gjendje që të sigurojnë fonde nga jashtë vendit dhe do të duhej dhënë atyre më shumë kohë për hulumtimet.

Pjesëtarët e personelit do të duhej poashtu që të tentonin të integronin mësimdhënien e tyre dhe punën kërkimore në një mënyrë që studentët e nivelit Bachelor dhe Master do të mund të shfrytëzoheshin si pjesë e hulumtimeve të bërë nga ta.

3.3 Gjetjet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar

Në lidhje me programet studimore të nivelit BA dhe MA Departamenti i Pedagogjisë duket se nuk ka ende dëshmi në lidhje me përpjekjet për ndërkombëtarizim, qoftë për pjesëtarët e personelit apo për studentët. Bazuar në diskutimet me pjesëtarët e personelit të Departamentit të Pedagogjisë, ata kanë krijuar disa bashkëpunime të fuqishme me disa universitete dhe institucione ndërkombëtare, për shembull në Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Slloveni dhe Finlandë.

Profesorët si dhe shumica e personelit mësimdhënës flasin anglisht dhe pjesërisht janë të arsimuar jashtë vendit. Shumë nga ta janë të përfshirë në baza individuale në bashkëpunim shkencor ndërkombëtar. Megjithatë, siç është cekur më herët studentët nuk shfaqin njohuri të mjaftueshme të gjuhëve të huaja. Përderisa kjo është gjendja, duket mjaft e vështirë që të zhvillohen programe të shkëmbimit ndërkombëtar për ta.

Rekomandimet në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe gjuhët e huaja

Departamenti do të duhej të kishte një strategji të qartë për ndërkombëtarizim që do të duhej të përfshinte një lloj shkalle mobiliteti të personelit akademik dhe të studentëve. Ata do të duhej edhe të inkurajoheshin të merrnin pjesë në programe të ndryshme mobiliteti, poashtu departamenti do të duhej të jetë i përkushtuar që t'i mbështesë si studentët ashtu edhe personelin mësimor. Poashtu, pjesëtarët e personelit duhet të inkurajohen që të japin mësim në gjuhë të huaj dhe t'i kërkojnë studentëve të tyre që të përdorin këto gjuhë. Hap pas hapi gjithnjë e më shumë lëndë mësimore duhet të jepen në gjuhë të huaja.

Duke qenë se Universiteti ka Fakultetin e Edukimit që është përqendruar në pedagogjinë shkollore dhe duke qenë se shumica e pjesëtarëve të Departamentit të Pedagogjisë duket se janë mjaft kompetent në fushën e pedagogjisë, rekomandohet fuqimisht që pjesëtarët e personelit në këtë departament do të duhej transferuar në Fakultetin e Edukimit. Pjesëtarët e personelit do të duhej të fillonin negocimin në mënyrë se si të kombinohen më së miri këto dy departamente dhe të punojnë së bashku në fushën e edukimit si një departament që do të mund të përqendrohej në trajnimin e Mësimdhënësve si dhe të ofronte hulumtime në nivel vendor dhe ndërkombëtar në atë fushë.

3.4 Gjetjet në lidhje me librat dhe publikimet mësimore

Gjatë vizitës në institucion ne patëm rastin që të vizitojmë bibliotekën e FF. Ne vërejtëm se aty kishte shumë libra të vjetër dhe jo edhe aq që ishin të ri. Kur të mendosh në lidhje me provimet e studentëve, sasia e librave studimor dukej se ishte mjaft e vogël. Ne na u tha që studentët mund të kopjojnë gjithë librin për provime, por kjo nuk duket të jetë një rrugë e arsyeshme. Studentët lexonin libra në bibliotekë, por sipas tyre kishte mungesë të librave në gjuhën shqipe. Studentët ishin në gjendje të huazonin vetëm disa libra, duke qenë se sasia e tyre ishte e kufizuar. Duket se kishte vetëm disa libra në lidhje me pedagogjinë shkollore dhe me temat edukative.

Ne na u tha që sasia në dispozicion për të blerë libra çdo vit ishte 20 000 Euro. Kjo duket të jetë shumë e vogël në krahasim me numrin e studentëve dhe duke marrë parasysh mungesën e shërbimeve online dhe materialeve elektronike. Ne nuk vërejtëm të ketë as revista shkencore.

Rekomandimet në lidhje me librat dhe materialet mësimore

Duke qenë se për studentët janë të rëndësishme librat e çfarëdo fushe shkencore në mënyrë që ata të jenë në gjendje që të fitojnë njohuri të rëndësishme për studimet e tyre si dhe për ngritjen e tyre në të ardhmen, është me rëndësi që Fakulteti përgjegjës për program të studimeve të buxhetojë mjete për libra dhe materiale tjera elektronike. Do të duhej ngritur një shërbim sistematik online.

Poashtu do të ishte e rëndësishme që pjesëtarët e personelit të departamenteve të fokusoheshin në përkthimin e disa materialeve mësimore në gjuhën shqipe dhe të përdorëshin të njëjtat në lëndët e tyre mësimore. Kjo do të mund të përfshihej në disa lëndë, në mënyrë që studentët më të aftë si pjesë e studimeve të tyre do të mund të përkthenin disa nga to.

3.5 Gjetjet në lidhje me personelin mësimor

Bazuar në diskutimet e zhvilluara me profesorë dhe mësimdhënës tjerë, dukej se ka problem me pagat joadekuate për profesorë, kjo krahasuar me ngarkesën e tyre. Ngarkesa është prej 6 orësh/javë dhe ajo nuk duket të jetë shumë e lartë nëse shihet prej një perspektive ndërkombëtare dhe ky orar do të duhej t'i mundësonte atyre që të kenë kohë për punë kërkimore. Megjithatë, ngarkesa e përgjithshme në punë mund të jetë disa herë më e lartë dhe do të duhej të ishte në kontekst të pagesës. Edhe mësimdhënësit dhe asistentët tjerë shprehën brengat e tyre në lidhje me pamjaftueshmërinë e pagesës, kjo krahasuar me ngarkesën e tyre.

Rekomandimet në lidhje me personelin mësimdhënës

Pagat do të duhej të merreshin në shqyrtim në mënyrë që të ngrihej motivimi i personelit akademik që të bëjnë punë kërkimore, si edhe të japin mësim. Ngritja e një të ashtuquajturit “udhëzuesi të karrierës” do të mund të ishte një mënyrë e shpërblimit të profesorëve dhe të mësimdhënësve bazuar në kompetencat e tyre dhe në sasinë e punimeve të publikuara. Mësimdhënësit do të duhej të kishin kohë për bashkëpunim ndërkombëtar si dhe për udhëheqje të grupeve kërkimore. Një mënyrë për të lehtësuar këtë proces do të ishte transferimi i Departamentit të Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit.

3.6 Gjetjet në lidhje me Programet Studimore dhe caktimin e kredive ECTS

Sipas RVV programi studimor i nivelit BA ka për synim që të ofrojë arsimim bazik në fushën e pedagogjisë së përgjithshme me një fokus në lëndët teorike dhe praktike në pedagogji dhe në kulturë. Rezultatet e pritura janë që kandidatët BA të jenë në gjendje që:

- Të ushtrojnë detyrat e një bashkëpunëtori profesional për kërkime pedagogjike;
- T'i asistojë ekspertët në hulumtime profesionale;

- Asistojë në përpilimin e projekteve pedagogjike dhe kulturore;
- Të animojë mësimin filozofik gjatë gjithë jetës;
- Të përfshihen në mënyrë të suksesshme në studimet e mëtejme të specializimit dhe të nivelit master.

Gjithë këto janë rezultate të çmuara që mbështeten nga një sasi e lëndëve që përqendrohen në ofrimin e njohurive për të përmbushur këto synime. Megjithatë, është e qartë që këto lëndë të cekura në planin e studimeve vetëm se u japin studentëve një pasqyrë të strukturave dhe funksioneve të institucioneve të ndryshme në fushën e arsimit dhe në zhvillimin social, më shumë se në fushën e pedagogjisë shkollore, që do të duhej të ishte synimi kryesor i Departamentit të Pedagogjisë.

Poashtu, sipas RVV programi i studimit në nivelin MA synon që të ofrojë arsimin bazik në fushën e pedagogjisë së përgjithshme me fokus në pedagogjinë teorike dhe shkencore. Rezultatet e pritura janë që kandidatët MA do të duhej që:

- Të zhvillojnë aktivitetin e një eksperti profesional për kërkime;
- Të zhvillojnë hulumtime profesionale;
- Të përpilojnë dhe të vlerësojnë projekte nga fusha pedagogjike dhe kulturore;
- Të promovojnë filozofinë e mësimin gjatë gjithë jetës;
- Të përfshihen në mënyrë të suksesshme në studimet postdiplomike, p.sh PhD.

Gjithë këto janë rezultate të çmuara që mbështeten nga një sasi e lëndëve që përqendrohen në ofrimin e njohurive për të përmbushur këto synime. Poashtu, programi MA do të duhej të përqendrohej më shumë në fushën e pedagogjisë shkollore në hulumtime në këtë fushë. Tani kjo përfshin fushën e filozofisë, sociologjisë, psikologjisë, historisë, shkencave politike, pedagogjisë dhe etnologjisë. Sigurisht që lëndët e cekura janë të rëndësishme, por do të duhej përcaktuar më mirë fokusi i programit.

Rekomandimet në lidhje me programin e studimeve dhe caktimin e kredive ECTS

I gjithë programi BA do të duhej të kishte një shtrirje më të gjerë profesionale dhe të fokusohej më shumë në çështjet pedagogjike dhe t'i përgatisë ekspertët për mësimdhënie në shkolla dhe në çështje mësimore përmes hulumtimeve pedagogjike. Siç është cekur në rezultatet e pritura, është me rëndësi që çështjet kulturore dhe shoqërore të merren parasysh në planin e studimeve. Në këtë mënyrë fakulteti do të mund të garantonte në mënyrë më të mirë që studentët e vet të nivelit bachelor të kenë mundësinë për të vazhduar studimet e tyre qoftë në nivelin master apo në fushat tjera pedagogjike. Megjithatë, kjo do të kërkonte planifikim të ri dhe diskutim në lidhje me planin e studimeve. Mësimdhënësit e nivelit BA do të duhej të mendonin në mënyrë të kujdesshme se cilat lëndë janë të nevojshme për marrjen e njohurive të nevojshme për mësimdhënës dhe për hulumtues si dhe për profesionet tjera në fushën e shkollimit dhe të garantojnë mundësitë për shkollimin gjatë gjithë jetës. Kurrikula poashtu do të duhej të siguronte mobilitetin e studentëve përmes ofrimit të mundësive për të studiuar dhe të bërë kërkime duke përdorur anglishte ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj.

Programi MA do të duhej të fokusohej në hulumtimet profesionale veçanërisht në fushën e shkollave dhe çështjeve shkollore duke përfshirë mësimin gjatë gjithë jetës, si dhe çështjet tjera të përgjithshme dhe të fushave kulturore.

Ai poashtu do të duhej të përfshinte më shumë lëndë që do të garantonin mobilitetin e studentëve. Mësimdhënia në anglisht do të duhej të ishte një nga synimet prioritare të programit MA. Është mjaft e rëndësishme që teza e studimeve MA do të duhej të shërbente si bazë për studimet PhD. Kjo do të kërkonte një planifikim të ri dhe diskutime në lidhje me planin e studimeve. Mësimdhënësit e nivelit MA do të duhej të mendonin në mënyrë të kujdesshme se cilat nga lëndët janë të nevojshme për fitimin e njohurive të nevojshme për mësimdhënës ekspertë në mënyrë që ata të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe studiojnë punën e tyre në të ardhmen. Ata poashtu do të duhej të mendonin me kujdes në lidhje me atë se cilat lëndë janë të nevojshme për të garantuar diversitet më të mirë për studentët e tyre për studimet e ardhshme.

Edhe pse në përgjithësi caktimi i kredive ECTS është i duhur dhe kuptimplotë, EE konsideron se do të ishte e nevojshme që të ngrihej numri i kredive ECTS që i dedikohen shkrimit të tezës BA në mënyrë që t'i lejojnë më shumë kohë studentëve për t'u ngritur në lidhje me shkrimin profesional akademik. Siç është cekur edhe në vlerësimin e mëparshëm të vitit 2009, ne do të rekomandonim caktimin e 9-12 kredive ECTS për tezen BA. Poashtu edhe sasia e kredive të caktuara për tezën MA do të duhej të ngrihej në 40 kredi ECTS në mënyrë që studentëve t'i lejohej të merrnin më shumë udhëzime në lidhje me përpilimin e seminareve hulumtuese në fillim të procesit hulumtues.

Siç është cekur edhe në rekomandimin e EE të 2009, ata patën rekomanduar fuqishëm që të dyja programet BA dhe MA të transferoheshin në Fakultetin e Edukimit. Bazuar në gjetjet e marra gjatë vizitës në institucion më 18 qershor 2012, duket që zgjidhja më e mirë që do të garantonte zhvillimin e Edukimit në Kosovë do të ishte kjo. Sipas raportit të vlerësimit edhe studentët nuk janë pajtuar me këtë fokusim të vogël në çështjet shkollore, kjo sipas pikëpamjes së tyre. Ata kanë shprehur në mënyrë të fuqishme dëshirën e tyre për të shtrirë fokusin e programit të studimeve drejt një fushe më të gjerë profesionale.

Rekomandimi përfundimtar

Të bëhet akreditimi i të dyja programeve në Pedagogji, atij në nivelin BA dhe MA me disa kufizime (shih Gjetjet dhe rekomandimet për detaje).

Në lidhje me të dyja programet BA dhe MA në Pedagogjinë e Përgjithshme, synimi duhet të fokusohet. Synimi do të duhej të ishte pedagogjia shkollore duke përfshirë këshillimin shkollor. Rekomandohet fuqimisht që të transferohet programi i studimeve në Fakultetin e Edukimit. Kjo do të garantonte më së miri edhe vazhdimin e studimeve për nivelin e doktoratës në fushën e edukimit dhe një mbikëqyrje më të mirë të mundshme të studentëve. Departamenti do të duhej të sigurote mbështetjen financiare qoftë për studentët apo për personelin mësimor në mënyrë që ata të publikojnë hulumtimet e tyre si në nivel vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Duke qenë se shihet se fakultetit i mungon një mision i qartë veçanërisht kur është fjala për Departamentin e Pedagogjisë dhe duke qenë se personeli i këtij të fundit janë ekspertë të mirë në fushën e pedagogjisë dhe edukimit, duket se është bjerrje parash dhe e kapaciteteve hulumtuese që ata të punojnë të shkëputur nga Fakulteti i Edukimit, ku shkencat edukative paraqesin një mision kryesor. Personeli shumë kompetent do të mund të fuqizonte fakultetin e Edukimit dhe në anën tjetër personeli i Departamentit të Pedagogjisë do të mund të përqendrohej më shumë në punë kërkimore duke ndarë detyrat e mësimdhënies me personelin e Fakultetit të Edukimit.

Sa më shpejt që të jetë e mundur do të duhej filluar negociatat për transferimin e Departamentit të Pedagogjisë dhe do të duhej të kishte një marrëveshje në mes Departamentit të Pedagogjisë dhe Fakultetit të Edukimit në lidhje me atë se cila është mënyra më e mirë për të arritur këtë. Të dyja palët do të duhej të vlerësonin ekspertizën e njëra-tjetrës dhe ta shfrytëzonin atë sa më mirë që të jetë e mundur.